



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER EDLIRA R. TELHARAJ  
ADRESA Rr. "ISMAIL QEMALI,  
PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE"  
TEL: 682072286

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2583

Nr. koleksioni: 1177

Tirane më 18/10/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021052800133689952



A2021052800133689952

## KONTRATE KALIMI KUOTASH ME DHURIM

Sot, para meje Notere EDLIRA R. TELHARAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr. "ISMAIL QEMALI, PALL. NR. 12, Kt. I - TIRANE", u paraqit personalisht:

### **DHURUES:**

**Suela Tuci**, atësia Ndue, amësia Bardhe, shtetase Shqiptare, lindur në Kurbnesh, Mirditë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr Bajram Curri; Nd. 472/1; H. 1; Ap. 7; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 09/12/1981, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035817617 dhe nr. personal I16209057C.

### **PRANUES I DHURIMIT:**

**Mirela Baboçi**, atësia Ndue, amësia Bardhe, shtetase Shqiptare, lindur në Mirditë dhe banuese në TIRANË, me adresë Kongresi I Lushnjës; Nd. 29; H. 1; Ap. 10; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 17/07/1977, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035737833 dhe nr. personal H75717055V.

*te cilet, ne baze te Ligjit Nr.110/2018 dt.20.12.2018 "Per Noterine" nenit 761 e vijues dhe e vijues te Kodit Civil, si dhe ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:*

### **TE DHENA TE PARAPRAKE**

- a. Shoqëria **"PRIMES ALBANIA"** sh.p.k, është regjistruar si person juridik ne Qendren Kombetare të Regjistrimit te Biznesit me NIPT me nr. L62122020K, ne date 22.09.2016, me kapital me vlerë **720.000 lekë** (shtateqind e njezete mije leke) dhe ka status aktiv.
- b. Dhuruesi eshte zoterues i **100 % (njqind)** të kapitalit të kësaj shoqërie.

### **NENI 1**

#### **Objekti**

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është kalimi nga Dhuruesi te Pranuesi i Dhurimit i 100% (njqind) te pjeseve te kapitalit të shoqërisë, pa kundershperblim dhe pa kusht.
- 1.2 Zhveshja e Dhuruesit nga te drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qenia pronar mbi 100% (njqind) te pjeseve të kapitalit të shoqërisë **"PRIMES ALBANIA" shpk**, objekt i dhurimit, nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate.

### **NENI 2**

#### **Kalimi i pronësisë**



A2021052800133689952

- 2.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate realizohet kalimi i 100% te pjesëve të kapitalit të shoqërisë **"PRIMES ALBANIA"** shpk nga Dhuruesi të Pranuesi i Dhurimit dhe Dhuruesi zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia që kishte mbi këte shoqëri.
- 2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate Pranuesi i Dhurimit bëhet zotëruar i 100 % të pjesëve të kapitalit të shoqërisë **"PRIMES ALBANIA"** shpk, duke marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga qenia pronar mbi 100% të aseteve të shoqërisë **"PRIMES ALBANIA"** shpk, nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

### NENI 3

#### Deklarime të palëve

- 3.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesin e Dhurimit se, pjesët e kapitalit të shoqërisë, që i transferohen Pranuesit të Dhurimit, pa asnjë kusht dhe kundërshtim, janë të lira nga çdo barrë apo rëndesë tjetër, dhe menjëherë lirisht të transferueshme të të tretet dhe mbi to nuk ka asnjë të drejtë juridike të të tretëve përveç Pranuesit të Dhurimit.
- 3.2 Pranuesi i Dhurimit, deklaron se e njëjti gjendjen e shoqërisë, e pranon transferimin nëpërmjet dhurimit në favor të tij, duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që do të burojnë nga qenia pronar mbi këte pjesë të kapitalit, të lindura nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

### NENI 4

#### Data efektive e kontratës

- 4.1 Kjo kontratë është e përvokueshme, e pakthyeshme, efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, që nga data e nënshkrimit të saj.

### NENI 5

#### Zgjidhja e Kontratës

- 5.1 Asnjë nga palët nuk mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë.

### NENI 6

#### Hartimi i Kontratës, aktet bashkëlidhur

- 6.1 Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje të barazvlerëshme, në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.
- 6.2 Kjo Kontratë zëvendëson çfarëdo marrëveshje, kontrate ose çfarëdo dokumenti tjetër dhe është e vetmja Kontratë detyruese për Palët në lidhje me objektin e Dhurimit

### NENI 7

#### Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 7.1 Kjo Kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 7.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, nëse vetë palët me ndihmë juridike vazhdojnë të mos t'i kuptojnë e zbatojnë, si dhe në rast se vetë palët nuk gjejnë mirëkuptim, mosmarrëveshjet bëhen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### NENI 8

#### Interpretimi i Kontratës në tërësi



A2021052800133689952

- 8.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndveshtrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

*Kontrata in lexua palëve me zë të lartë e të qartë nga unë Noteri. U lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj regullisht, në përputhje me ligjin.*

## PALËT

### DHURUESI

Suela Tuci



NOTER

EDLIRA R. TELHARAJ

### PRANUES I DHURIMIT

Mirela Baboçi

Mirela Baboçi

---

**REZULTATET E KËRKIMIT**

---

|                                 |                     |
|---------------------------------|---------------------|
| Numri i Rezultatit të Kerkimit: | D-20211014113441436 |
| Data e Rezultatit të Kerkimit:  | 14.10.2021          |
| Ora e Rezultatit të Kerkimit:   | 11:34:41AM          |
| Lloji i Kerkimit:               |                     |
| Numri i Dokumentit:             | D-400-577-702       |
| Referenca e Perdoruesit:        |                     |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

SUELA NDUE TUCI  
PRIMES ALBANIA SH.P.K.



*Elë Kaman*